



01 Nr. 468/25 Dt. 29.07.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 lidhur me nenin 18 paragrafi 1.9 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 93447 të datës 22.07.2025 të Myvedete Haxhibeqiri, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa e 01-030 nr. 93447 të datës 22.07.2025 e Myvedete Haxhibeqiri, nëna e pianistes Hira Haxhibeqiri nga Prizreni, e cila është nxënëse e Shkollës së Mesme të Muzikës "Lorenc Antoni", për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth pjesëmarrjes së Hira Haxhibeqiri në Koncertin Ndërkombëtar recital, që do të mbahet me 01 gusht 2025 në Romë të Italisë, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të udhëtimit, të 2 personave (Myvedete Haxhibeqiri dhe Hira Haxhibeqiri), lejohen mjetet financiare në shumën prej 700 € (shtatëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
3. Mjetet e lartcekura, si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të alokohen në xhirollogarinë e Myvedete Haxhibeqiri –(nëna e pianistes Hira Haxhibeqiri) .
4. Me këtë vendim anulohet Vendimi 01 nr. 428/25 i datës 18.07.2025.
5. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➤ Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurës,
- Arkivës së Kryetarit.

